- (b) Nëse ka ndonjë mospërputhje tek çmimi total, kur totali është shuma ose diferenca e nëntotaleve, çmimi i nëntotalit mbizotëron dhe çmimi total korrigjohet në

bazë të tij. Në këtë rast, do të korrigjohet edhe shuma në fjalë, e cila ka lidhje me gabimin.

- (c) Nëse ka ndonjë mospërputhje ndërmjet shumës në fjalë dhe shumës në shifra, mbizotëron shuma në fjalë. Bën përjashtim nga ky rregull situata kur, shuma në fjalë ka mospërputhje me shumën në shifra, ndërkohë që kjo e fundit nuk ka gabime aritmetike në përlllogaritjen e zërave të ofertës.

Në çdo rast, Ofertat me gabime aritmetike refuzohen kur:

- shumat absolute të të gjitha korrigjimeve janë më shumë se 2% e vlerës së ofertës ekonomike të ofruar;
- shuma absolute e të gjitha korrigjimeve është më pak se 2%, por nuk pranohet korrigjimi nga ofertuesi.

2. Në rastin kur janë të vlefshme dy ose më pak oferta, në përputhje me nenin 93 të LPP-së, oferta vlerësohet anomalisht e ulët kur ajo është ulur më shumë se 25% të fondit limit të përlllogaritur.

Në rast kur janë të vlefshme tre ose më shumë oferta, në përputhje me nenin 93 të LPP-së, oferta vlerësohet anomalisht e ulët nëse vlera e saj do të jetë më e vogël se 85% e mesatares së ofertave të vlefshme.

Në procedurat e prokurimit me vlerë nën kufijtë e lartë monetarë, nëse një apo disa oferta vlerësohen si anomalisht të ulëta, Komisioni i Vlerësimit të Ofertave i refuzon ato, duke i skualifikuar nga procedura, pa i kërkuar sqarim ofertuesit/sve.

Në procedurat e prokurimit me vlerë mbi kufijtë e lartë monetarë, nëse një apo disa oferta vlerësohen si anomalisht të ulëta, Komisioni i Vlerësimit të Ofertave duhet ti kërkojë operatorit ekonomik të paraqesë brenda tre ditëve pune, shpjegime të çmimit ose kostove të propozuara në ofertë, në përputhje me nenin 93 të LPP-së dhe të vlerësojnë informacionin e dhënë, në konsultim me ofertuesin, në përputhje me dispozitat e këtij neni.

Në çdo rast, ofertuesi ka detyrimin të justifikojë dhe dokumentojë me prova me shkrim, shpjegime për elementin/elementët specifike të ofertës, në përputhje me kërkesat e nenit 93 të LPP-së.

2.1 Formula që duhet zbatuar, për të vlerësuar një ofertë

anomalisht të ulët, në rastin kur ekzistojnë tre ose më shumë oferta të vlefshme, është si më poshtë:

O - Oferta

MO – Mesatarja e ofertave të vlefshme

N - Numri i ofertave të vlefshme

PR (Zm) – Zbritje e mundshme

$$MO = O1 + O2 + O3 + \dots On / N$$

$$PR = 85 \% Mo$$

Vlera e ofertave të vlerësuara < .. PR rrjedhimisht oferta është anomalisht e ulët.

3. Nëse një Operator Ekonomik nuk pranon korrigjimin e gabimeve aritmetike, ose nëse Ofertuesi nuk arrin të japë një justifikim për të bindur Autoritetin/Entin Kontraktor, në rast të një oferte anomalisht të ulët, Oferta e tij do të refuzohet.

4. Procesi i hedhjes së shortit

Nëse dy ose më shumë oferta kanë të njëjtin çmim më të ulët ose kanë të njëjtat pikë, atëherë fituesi përcaktohet me short, në prani të ofertuesve. Ofertuesit njoftohen për datën dhe kohën e hedhjes së shortit. Mospjesëmarrja e ofertuesve gjatë procesit të hedhjes së shortit nuk përbën arsye për skualifikim.

D. DHËNIA E KONTRATËS

23. Njoftimi i Fituesit

1. Brenda afatit të vlefshmërisë së Ofertës, Autoriteti/Enti Kontraktor njofton Operatorin Ekonomik të suksesshëm se, Oferta e tij është pranuar, dhe është shpallur fituese.

24. Nënshkrimi i Marrëveshjes Kuadër/ Kontratës

1. Pas konfirmimit të fituesit/ve Autoriteti/Enti Kontraktor përgatit, nënshkruan dhe fton Operatorin/ët e suksesshëm Ekonomik të nënshkruajë Marrëveshjen kuadër/Kontratën.

2. Autoriteti/Enti Kontraktor i kërkon fituesit një sigurim për realizimin e Kontratës. Shuma e mbulimit për realizimin e kontratës do të jetë 10% e vlerës së Kontratës. Formulari i Sigurimit të Kontratës, dorëzohet

para nënshkrimit të Kontratës.

Sigurimi për realizimin e kontratës mund të paraqitet në një nga format e mëposhtme:

- a) mundësi pagese nga ofertuesi në vlerë monetare, në llogarinë e autoritetit ose entit kontraktor;
- b) garanci bankare
- c) garanci nga shoqëri sigurimi.

DH. ANKESAT

25. Procedura e ankesës

1. Çdo Operator Ekonomik, i cili ka interes të ligjshëm për objektin e prokurimit dhe rrezikon të dëmtohet nga vendimmarrja e autoritetit/entit kontraktor mund të paraqesë ankesë njëkohësisht pranë autoritetit/entit kontraktor dhe Komisionit të Prokurimit Publik në lidhje me Dokumentet e Tenderit, kualifikimin, përzgjedhjen ose përcaktimin e ofertës fituese, sipas parashikimeve në LPP dhe aktet nënligjore, në Sistemin e Ankesave Elektronike.
2. Në rastet e ankesave për vendimet e autoritetit ose entit kontraktor për përzgjedhjen e kandidatëve pas fazës së parakualifikimit ose për procesin e vlerësimit të ofertave, operatorët ekonomikë, të cilët kanë marrë pjesë në procedurën e prokurimit dhe mund të cenohen nga ankesa e paraqitur, kanë të drejtë të paraqesin argumentet e tyre në lidhje me këtë të fundit njëkohësisht pranë autoritetit ose entit kontraktor dhe Komisionit të Prokurimit Publik.

Kundër vendimit të autoritetit ose entit kontraktor, operatorët ekonomikë të interesuar, të cilët kanë paraqitur argumentet e tyre në lidhje me ankesën, kanë të drejtën të ankohen pranë Komisionit të Prokurimit Publik.

3. Autoriteti/Enti Kontraktor mund t'i kërkojë Komisionit të Prokurimit Publik që të lëshojë masa të ndërmjetme për mospezullimin e procedurës së prokurimit.

E. ANULIMI I PROCEDURËS

26. Anulimi i procedurës

1. Autoriteti / Enti kontraktor publikon Njoftimin për

Anulimin e Procedurës së Prokurimit, në të njëjtën mënyrë siç publikon Njoftimin e Kontratës, jo më vonë se 5 (pesë) ditë nga data e skadimit të afatit të fundit për paraqitjen e ankesave, ose dhënien e vendimit përfundimtar për ankimin.

2. Autoriteti/ enti kontraktor anulon procedurën e prokurimit në rastet kur:

a) nuk është paraqitur asnjë kërkesë e përshtatshme në procedurat me faza;

b) nuk është paraqitur asnjë ofertë e përshtatshme në procedurat me një fazë;

c) konstaton se dokumentet e tenderit përmbajnë gabime ose mangësi të rëndësishme;

d) për shkak të rrethanave të paparashikueshme dhe objektive, nevojat ose aftësia paguese e autoritetit ose entit kontraktor ka ndryshuar;

e) Komisioni i Prokurimit Publik vendos anulimin në përputhje me parashikimet në LPP;

Gjithashtu, Titullari i autoritetit/entit vendos anulimin e procedurës sipas përcaktimeve në nenin 19 të LPP dhe nenin 75 të VKM 285/2021, të ndryshuar.

3. Kur procedura e prokurimit publik anulohet në përputhje me shkronjën "d" të paragrafit 2, autoriteti/ enti kontraktor nuk duhet të shpallë një procedurë të re për të njëjtin objekt të prokurimit dhe me të njëjtat të dhëna.

4. Nëse, Autoriteti/Enti Kontraktor duhet të rishpallë një procedurë të re për të njëjtin objekt të prokurimit dhe me të njëjtat të dhëna, nuk duhet të vijojë me rishpalljen e saj në Sistemin e Prokurimit Elektronik përpara përfundimit të afateve të ankimimit/shqyrtimit të ankesave dhe vendimit të marrë lidhur me to.

SEKSIONI II: LISTA E SHTOJCAVE

Shtojca 1: Formulari i Ofertës [Ekonomike](#)

Shtojca 2: Lista e Çmimeve sipas elementëve përbërës të shërbimit

Shtojca 3: Formulari i Sigurimit të Ofertës

Shtojca 4: Lista e Informacionit Konfidencial

Shtojca 5: Deklaratë mbi disponueshmërinë e anëtarit të stafit

Shtojca 6: Formulari i Specifikimeve Teknike

Shtojca 7: Formulari i Shërbimeve dhe Grafikut të ekzekutimit

Shtojca 8: Formulari i Termave të Referencës

Shtojca 9: Formulari i Kriteve të Përzgjedhjes së Ofertuesve

Shtojca 10: Formulari Përmbledhës i Vetëdeklarimit

Shtojca 11: Formulari i Njoftimit të skualifikimit

Shtojca 12: Formulari i Njoftimit të Fituesit, pas publikimit të të cilit fillojnë afatet e ankimimit

Shtojca 13: Formulari i Njoftimit të Fituesit, në përfundim të afateve të ankimimit

Shtojca 14: Formulari i Njoftimit të Operatorëve Ekonomikë të Suksesshëm në Marrëveshjen Kuadër, pas publikimit të të cilit fillojnë afatet e ankimimit.

Shtojca 15: Formulari i Njoftimit të Operatorëve Ekonomikë të Suksesshëm në Marrëveshjen Kuadër, në përfundim të afateve të ankimimit.

Shtojca 16: Formulari i Njoftimit të Anulimit të Procedurës së Prokurimit, pas publikimit të të cilit fillojnë afatet e ankimimit

Shtojca 1.

(Shtojcë për t'u paraqitur nga operatori ekonomik)

FORMULARI I OFERTËS EKONOMIKE⁵

Data:

Numri i referencës së procedurës së prokurimit/lotit:

Për: **[Operatori Ekonomik shënon emrin e Autoritetit/Entit Kontraktor]**

Emri i ofertuesit dhe NIPT-i **[Operatori Ekonomik shënon emrin e ofertuesit dhe NIPT-in]**

Ne, të nënshkruarit, deklarojmë se:

- (a) Kemi konsultuar dhe nuk kemi asnjë rezervë për Dokumentet e Tenderit të procedurës me objekt:**[shënoni objektin e procedurës së prokurimit të publikuar në SPE]**, përfshirë sqarimet dhe Shtojcat e nxjerra.
- (b) Ne **[vendos emrin e Operatorit Ekonomik dhe numrin unik të identifikimit, dhe/ose anëtarët e BOE, nëse është rasti]**, nuk jemi -të përjashtuar nga e drejta për të fituar kontrata publike dhe jemi në përputhje me kërkesat e kualifikimit dhe kërkesat specifike të kontratës siç specifikohet në njoftimin e kontratës **[vendos objektin e procedurës së prokurimit/lotit]**.
- (c) Ne ofrojmë të kryejmë për Autoritetin/Entin Kontraktor **[vendos emrin e Autoritetit/entit Kontraktor]**, në përputhje me Dokumentet e Tenderit (shih më poshtë), Shërbimet për **[vendosni CPV-në e procedurës/Lotit përkatës nga Njoftimi i Kontratës të publikuar në SPE]** në përputhje me Ofertën Teknike, me çmimet e renditura në Listën e Çmimeve sipas elementëve përbërës të shërbimit dhe në përputhje me Termat dhe Kushtet e Kontratës, të cilat reflektohen në Dokumentet e Tenderit.
 - (d) Oferta jonë është në përputhje me dokumentet e mëposhtme:
 - 1. Udhëzimet për Operatorët Ekonomikë;
 - 2. Njoftimin e Kontratës;
 - 3. Kriteret e Përzgjedhjes;
 - 4. Specifikimet teknike, grafikun e ekzekutimit dhe termat e referencës;
 - 5. Kushtet e Përgjithshme të Kontratës;
 - 6. Kushtet e Veçanta të Kontratës;

⁵ Vlera e ofertës ekonomike nuk duhet të kalojë dy shifra pas presjes dhjetore.

7. Lista e Çmimeve sipas elementëve përbërës të shërbimit.

- (e) Çmimi total i Ofertës sonë, **pa TVSH**, është: ----- **[Operatori Ekonomik e vendos në shifra dhe fjalë];**
- (f) Çmimi total i Ofertës sonë, **me TVSH**, është: ----- **[Operatori Ekonomik e vendos në shifra dhe fjalë];**

Emri i përfaqësuesit të ofertuesit	
Nënshkrimi	
Vula	
Datë _____	

Shtojca 2.

(Shtojcë për t'u paraqitur nga operatori ekonomik)

LISTA E ÇMIMEVE SIPAS ELEMENTËVE PËRBËRËS TË SHËRBIMIT

Data: _____

Numri i referencës së procedurës së prokurimit/lotit:

Emri dhe numri unik i identifikimit të Operatorit Ekonomik/Operatorëve ekonomikë (në rast BOE): _____

Monedha: _____

Në rast të mospërputhjes midis çmimit për njësi dhe totalit, do të zbatohen rregullat e përcaktuara në Udhëzimet për Operatorët Ekonomikë.

Çmimet dhe monedhat të jenë në përputhje me Udhëzimet për Operatorët Ekonomikë.

Të gjithë elementëve përbërës të ofertës ekonomike duhet t'u vendoset çmimi i ofruar në këtë Listë, pasi elementët e Ofertës Ekonomike pa vlerë do të konsiderohen si shërbime të paofruara dhe do të cojnë në refuzimin e ofertës.

1	2	3	4	5	
Nr.	Përshkrimi i elementëve të përbërës të Ofertës Ekonomike	Sasia	çmimi për njësi	Çmimi total (3 x 4X)	
1.					
2.					
3.					
4					
	Çmimi total				_____
Çmimi Neto pa TVSH					
TVSH (%)					

Çmimi total me TVSH:	
Emri i përfaqësuesit të ofertuesit	
Nënshkrimi	
Vula	
Datë _____	

Shtojca 3.

[Shtojcë për t'u paraqitur nga operatori ekonomik)

[Letër me kokë e Bankës / Kompanisë së Sigurimeve]

FORMULARI I SIGURIMIT TË OFERTËS

Për: [Emri dhe adresa e autoritetit/entit kontraktor]

Në emër të: [Emri dhe adresa e ofertuesit të siguruar]

* * *

Procedura e prokurimit [lloji i procedurës]

Përshkrim i shkurtër i kontratës: [objekti]

Publikimi (nëse zbatohet): Buletini i Njoftimeve Publike [Data] [Numri]/Nr. Referencës në faqen e APP-se

* * *

Duke iu referuar procedurës së lartpërmendur,

Ne vërtetojmë se [emri i ofertuesit të siguruar] ka derdhur një depozitë pranë [emri dhe adresa e bankës] / është garantuar pranë [emri dhe adresa e kompanisë së sigurimit] me një vlerë prej [monedha dhe vlera, e shprehur në fjalë dhe shifra] si kusht për sigurimin e ofertës, dorëzuar nga operatori i lartpërmendur ekonomik.

Marrim përsipër të transferojmë në llogarinë e [emri i autoritetit/entit kontraktor] vlerën e siguruar, brenda 15 (pesëmbëdhjetë) ditëve nga kërkesa juaj e thjeshtë dhe e parë me shkrim, pa kërkuar shpjegime, me kusht që kjo kërkesë të përmendë mospërmbushjen e njërit nga kushtet e mëposhtme:

- Ofertuesi e ka tërhequr ose ka ndryshuar ofertën, pas afatit përfundimtar për paraqitjen e ofertave ose para afatit përfundimtar, nëse është përcaktuar kështu në dokumentat e tenderit;
- Ofertuesi ka refuzuar nënshkrimin e kontratës së prokurimit kur autoriteti/enti kontraktor e kërkon një gjë të tillë;
- Ofertuesi nuk ka paraqitur sigurimin e kontratës, ku oferta është shpallur fituese ose nuk ka plotësuar ndonjë kusht tjetër përpara nënshkrimit të kontratës së përcaktuar në dokumentat e tenderit.

Ky Sigurim është i vlefshëm për periudhën e specifikuar në [njoftimin e kontratës].

[Përfaqësuesi i bankës / kompanisë së sigurimit]

Shtojca 4.

(Shtojcë për tu paraqitur nga Operatori Ekonomik, nëse është rasti)

Lista e Informacionit Konfidencial

(Shkruani informacionin që dëshironi të mbetet konfidencial)

Lloji, natyra e informacionit që duhet mbajtur konfidencial	Numri i faqeve dhe pikave në DST që dëshironi të mbeten konfidenciale	Arsyet e mbajtjes konfidencial të këtij informacioni	Afati i fundit për mbajtjen konfidencial të këtij informacioni

VËMENDJE

Çdo e dhënë që nuk është regjistruar si konfidenciale do të konsiderohet se për të është dhënë pëlqimi i mbajtësit të një informacioni të tillë dhe Autoriteti/Enti Kontraktor nuk do të jetë përgjegjës për nxjerrjen e këtij informacioni.

Nuk konsiderohet se përbën sekret tregtar informacioni që duhet të bëhet publik sipas ligjit, që ka të bëjë me një shkelje të ligjit ose që duhet të publikohet në bazë të praktikave të mira tregtare dhe parimeve të etikës tregtare. Konkretisht: Operatori ekonomik nuk mund të klasifikojë si konfidencial: çmimin e ofertës, listën e çmimeve, katalogun, informacionin lidhur me kriteret e përzgjedhjes së ofertës, dokumentet publike, fragmente nga regjistrat publikë dhe informacione të tjera që duhet të bëhen publike ose që nuk janë konfidenciale në përputhje me legjislacionin në fuqi.

like ose që nuk janë konfidenciale në përputhje me legjislacionin në fuqi.

Përfaqësuesi i Ofertuesit

Nënshkrimi

Vula

Shtojca 5.

(⁶Shtojcë për t'u plotësuar nga operatori ekonomik)

DEKLARATË

Mbi disponueshmërinë e anëtarit të stafit

Deklaratë për procedurën e prokurimit publik që do të zhvillohet në datë _____ nga Autoriteti/Enti Kontraktor _____ me objekt _____ me fond limit _____.

Unë i nënshkruari _____, në cilësinë e anëtarit të stafit të operatorit ekonomik “.....” për procedurën e prokurimit me objekt _____ nën përgjegjësinë time personale, **Deklaroj** se:

1. Autorizoj VETËM operatorin ekonomik “.....” të paraqesë personin tim dhe të gjithë dokumentacion e nevojshëm, si anëtar i stafit të tij në procedurën e prokurimit publik që do të zhvillohet në datë _____ nga Autoriteti/Enti Kontraktor _____ me objekt _____ me fond limit _____.

Deklarimi i personit tim, si anëtar i stafit nga ana e çdo operatori ekonomik tjetër, për procedurën e prokurimit me objekt është i pamiratuar dhe pa pëlqimin e personit tim.

2. Jam i disponueshëm në realizimin e objektit të prokurimit, sipas kushteve dhe afateve të përcaktuara nga autoriteti/enti kontraktor.

Data e dorëzimit të deklaratës _____

Emri, Mbiemri, Nënshkrimi

⁶ Kjo Shtojcë do të paraqitet në rastin e kontratave për shërbime me natyrë intelektuale, ku nuk mbizotërojnë aspektet fizike të veprimtarisë dhe që kërkojnë ekspertizë të posaçme.

Shtojca 6.

[*Shtojcë për t'u plotësuar nga Autoriteti/Enti Kontraktor*]

FORMULARI I SPECIFIKIMEVE TEKNIKE

Specifikimet Teknike të shërbimeve objekt i prokurimit, duhet të përshkruhen sa më saktë dhe plotësisht, për sa të jetë e mundur, duke krijuar kushte për konkurrencë të paanshme dhe të hapur midis të gjithë kandidatëve dhe ofertuesve. Specifikimet teknike, me përjashtim të rasteve plotësisht të justifikuara, duhet të hartohen në mënyrë të tillë që të marrin parasysh kriteret e aksesit për personat me aftësi të kufizuara ose projektimin për të gjithë përdoruesit, siç kërkohet nga ligji në fuqi.

SHËNIM: Në Specifikimet Teknike, nuk duhet të përshkruhet asnjë markë specifike prodhimi ose burim ose proces i veçantë, që karakterizon produktet ose shërbimet e ofruara nga një Operator specifik Ekonomik ose ndonjë markë tregtare, patentë, tip ose origjinë ose prodhim specifik, për të favorizuar ose eliminuar ndërmarrje ose produkte të caktuara. Një gjë e tillë lejohet vetëm në raste të jashtëzakonshme kur nuk ekziston një mënyrë e mjaftueshme, e saktë ose e kuptueshme për të përshkruar objektin e Kontratës. Referencat e tilla duhet të shoqërohen me fjalët "ose ekuivalent".

Në hartimin e specifikimeve teknike, autoritetet /entet kontraktore mbajnë në konsideratë detyrimet e përcaktuara në legjislacionin përkatës në fushat, si më poshtë:

- a) Kërkesat minimale të performancës së energjisë, siç përcaktohet në legjislacionin në fuqi për efikasitetin e energjisë dhe për performancën energjetike në ndërtesa, konsumin e energjisë dhe burimeve të tjera të produkteve me ndikim në energji, përfshirë parashikimet për përdorimin e etiketave për produktet me ndikim në energji;
- b) Specifikimet teknike për produkte të caktuara, siç përcaktohet në aktet ligjore dhe nënligjore të fushës me qëllim përmirësimin e performancës energjetike dhe uljen e ndikimit;
- c) Çdo parashikim tjetër që buron nga legjislacioni mjedisor, energjetik, social dhe i punës.

Skicimet, parametrat teknik etj:

Specifikimi i Materialeve:

Përshkrimi i kërkesave të zbatimit të shërbimeve në lidhje me to:

Objekti i prokurimit

Riparim, mirembajtje dhe furnizim me pjese kembimi per mjetet lundruese te Drejtorise së Shërbimeve të Peshkimit dhe Akuakulturës.

1. Qellimi i kontrates

Sigurimi i shërbimeve te specializuara per diagnostikimin, riparimin dhe mirembajtjen parandaluese e korrigjuese te mjeteve lundruese.

2. Fusha e shërbimit

Perfshin motore detare, sisteme drejtimi, sisteme elektrike, elektronike, navigimi, komunikimi, karburanti dhe strukturen e mjetit.

Në hartimin e specifikimeve teknike, autoritetet kontraktore mbajnë në konsideratë detyrimet e përcaktuara në legjislacionin përkatës në fushat, si më poshtë:

3. Riparimet e trupit te mjetit

Riparime strukturore, trajtime antikoroze, pastrimin dhe lysterje me boje detare profesionale.

4. Sistemet e navigimit/ elektronik/ elektrike dhe komunikimit

GPS, radar, sonar, AIS, VHF etj., dhe pajisje sinjalizimi, sisteme dhe pajisje elektronike dhe sisteme elektrike.

Klasifikimi i Riparimeve:

- 1) Riparime profilaktike ,
- 2) Riparime difektesh,
- 3) Riparime të përgjithshme,

I. Të dhëna teknike për Agregatet / Pajisjet / Pjesët e këmbimit:

- a) duhet të jenë të reja;
- b) të jenë prodhime origjinale nga prodhuesi i mjetit ose nga distributorë të autorizuar nga prodhuesi i mjetit;
- c) Vaji i motorrit të jetë i çertifikuar sipas standarteve ndërkombëtare ACEA, API ose standardeve kombëtare / ndërkombëtare ekuivalente me to.

II. Afati i garancisë së Aggregateve / Pajisjeve / Pjesëve të këmbimit:

Agregatet / Pajisjet / Pjesët e këmbimit duhet të ofrohen sipas afateve të garancisë të dhëna nga prodhuesi i mjeteve lundruese ose nga distributorë të autorizuar nga prodhuesi i mjeteve lundruese.

III. Shërbimi që kërkohet:

- 1) Riparimet / mirëmbajtja e mjeteve nga ana e Operatorit Ekonomik, do të kryhet sipas kërkesave teknike dhe në përputhje të plotë me normat dhe standartet e miratuara për këtë qëllim.
- 2) Riparimet / mirëmbajtja e mjeteve pranë Operatorit Ekonomik, do të kryhet në mënyrë periodike, sipas kërkesave të Autoritetit Kontraktor.
- 3) Operatori Ekonomik ka detyrimin e kryerjes së transportit të mjeteve lundruese, nga vend bllokimi i tyre deri në servis, nëpërmjet shërbimit me karrel dhe pa pagesë shtesë.

5. Detyrat në lidhje me shërbimin:

-
- Në prezencë të përfaqësuesit të Autoritetit Kontraktor, Operatori Ekonomik mbasi ka kryer testimin e difektimit të mjetit, në paisjet përkatëse, evidenton difektet e mundëshme dhe Operatori ekonomik nis procesin e riparimit, i cili duhet të përfundojë brënda afateve kohore të dakortësuara.
 - Me përfundimin e riparimit të mjetit, personi përgjegjës, i autorizuar pranë servisit, njofton Autoritetin Kontraktor, për përfundimin e riparimit të mjetit, në mënyrë që të bëhet tërheqja e mjetit pranë servisit.
 - Përfaqësuesi i Autoritetit Kontraktor paraqitet pranë servisit dhe bën verifikimin e shërbimit të kryer dhe pjesët e ndërrimit të zëvendësuara, sipas preventivit të miratuar. Nëse të dy palët janë dakortësuar, mbi volumin e punimeve të kryera, hartohet procesverbal i përbashket, në tre kopje, në prani të përfaqësuesit të Autoritetit Kontraktor, drejtuesit të mjetit si dhe Operatorit Ekonomik.
 - Proçesi përfundimtar i riparimit të mjetit, krahas procesverbalit, shoqërohet me faturën tatimore

6. Afatet e ekzekutimit: 24 (njezet e kater) muaj nga data e nënshkrimit të Marrëveshjes Kuadër. Afati i kontratës së shërbimit do të jetë 24 (njezet e kater) muaj nga nënshkrimi.

Shtojca 7.

(Shtojcë për t'u plotësuar nga Autoriteti/Enti Kontraktor)

(Kjo Shtojcë në rastin e Marrëveshjes Kuadër do të plotësohet nga autoriteti/enti kontraktor vetëm gjatë rihapjes së procesit të mini-konkursit)

FORMULARI I SHËRBIMEVE DHE GRAFIKUT TË EKZEKUTIMIT

Shërbimi që kërkohet: Riparimi / mirëmbajtja e mjeteve lundruese, do të kryhet sipas kërkesave teknike dhe në përputhje të plotë me normat dhe standartet e miratuara për këtë qëllim.

Riparimet / mirëmbajtja e mjeteve pranë Operatorit Ekonomik, do të kryhet në mënyrë periodike, sipas kërkesave të Autoritetit Kontraktor.

Operatori Ekonomik ka detyrimin e kryerjes së transportit të mjeteve, të cilat janë të difektuara dhe nuk kanë mundësi për vetëlëvizje, nga vend bllokimi i tyre deri në servis, nëpërmjet shërbimit me karrel dhe pa pagesë shtesë.

Afatet e ekzekutimit: 24 (njetzet e kater) muaj nga data e nënshkrimit të Marrëveshjes Kuadër. Afati i kontratës së shërbimit do të jetë 24 (njetzet e kater) muaj nga nënshkrimi.

Skaf plastik vendndodhja Shëngjin, Motorri Selva, Fuqia 115 HP

Nr.	Emërtimi i Shërbimit	Njësia	Sasia e pritshme	Afati i ekzekutimit
1	Furnizim & vendosje kandelesh	cope	12	24 muaj
2	Furnizim & vendosje filter vaji	cope	2	24 muaj
3	Furnizim & vendosje parafilter benzine	cope	2	24 muaj
4	Furnizim & vendosje filter benzine	cope	2	24 muaj
5	Furnizim & vendosje termostate	cope	2	24 muaj

6	Furnizim & vendosje pompe uji	set	2	24 muaj
7	Furnizim & vendosje komba e helikes	cope	2	24 muaj
8	Furnizim & vendosje vaj i kembes	litra	4	24 muaj
9	Furnizim & vendosje droza e gazit, leva e gazit, droza e marshit	set	2	24 muaj
10	Furnizim & vendosje tub shkarkimi	cope	2	24 muaj
11	Furnizim & vendosje flotorq hub	set	2	24 muaj
12	Furnizim & vendosje guarnicion testate	cope	2	24 muaj
13	Furnizim & vendosje helike	cope	2	24 muaj
14	Furnizim & vendosje piston i ngritjes se motorrit	cope	2	24 muaj
15	Furnizim & vendosje gomine e kembes	cope	2	24 muaj
16	Furnizim & vendosje pakete elektronike (centraline)	cope	2	24 muaj
17	Furnizim & vendosje panel komandimi	set	2	24 muaj
18	Furnizim & vendosje vaj motorri Selva 115 HP	litra	24	24 muaj
19	Furnizim & vendosje sprajt graso	cope	4	24 muaj
20	Sherbim mirembajtje rrjeti elektrik	ore	4	24 muaj
21	Sherbim ngjitje, kruarje, lysterje me boje	cope	2	24 muaj
Gomone vendndodhja Vlorë, Motorri Mercury, Fuqia 115HP				
Nr.	Emërtimi i Shërbimit	Njësia	Sasia e pritshme	Afati i ekzekutimit
1	Furnizim & vendosje filter benzine	cope	2	24 muaj
2	Furnizim & vendosje parafilter benzine	cope	2	24 muaj
3	Furnizim & vendosje pompe uji	cope	2	24 muaj
4	Furnizim & vendosje anoda	set	2	24 muaj
5	Furnizim & vendosje impeler	cope	2	24 muaj
6	Furnizim & vendosje pompaci Benzine	cope	2	24 muaj
7	Furnizim & vendosje staka baterie	set	2	24 muaj
8	Furnizim & vendosje fishat e korentit	set	2	24 muaj
9	Furnizim & vendosje modul pompe benzine	cope	2	24 muaj
10	Furnizim & vendosje helike	cope	2	24 muaj

11	Furnizim & vendosje flotorq hub	set	2	24 muaj
12	Furnizim & vendosje gomine e kembes	cope	2	24 muaj
13	Furnizim & vendosje pakete elektronike (centralin)	cope	2	24 muaj
14	Furnizim & vendosje vaj kembe	litra	4	24 muaj
15	Furnizim & vendosje vaj motorri Mercury 115 HP	litra	24	24 muaj
16	Furnizim & vendosje sprajt graso	cope	4	24 muaj
17	Sherbim mirembajtje rrjeti elektrik	ore	4	24 muaj
18	Sherbim ngjitje, kruarje, lyerje me boje	cope	2	24 muaj
Motorr vendndodhja Sarandë, Motorri Suzuki, Fuqia 15HP				
1	Furnizim & vendosje filter benzine	cope	2	24 muaj
2	Furnizim & vendosje parafilter benzine	cope	2	24 muaj
3	Furnizim & vendosje kapucat e kandeleva + kandeleva	cope	4	24 muaj
4	Furnizim & vendosje filter vaji	cope	2	24 muaj
5	Furnizim & vendosje vaj motorri 15 HP	cope	2	24 muaj
Varkë plastike vendndodhja Shkoder, Motorri Selva, Fuqia 50 Hp				
Nr.	Emërtimi i Shërbimit	Njësia	Sasia e pritshme	Afati i ekzekutimit
1	Furnizim & vendosje filter benzine	cope	2	24 muaj
2	Furnizim & vendosje parafilter benzine	cope	2	24 muaj
3	Furnizim & vendosje kandeleva	cope	8	24 muaj
4	Furnizim & vendosje impeler	cope	2	24 muaj
5	Furnizim & vendosje helike	cope	2	24 muaj
6	Furnizim & vendosje tub shkarkimi	cope	2	24 muaj
7	Furnizim & vendosje gomine e kembes	cope	2	24 muaj
8	Furnizim & vendosje flotorq Hub	kit	2	24 muaj
9	Furnizim & vendosje vaj motorri Selva 50 HP	litra	12	24 muaj
10	Furnizim & vendosje vaj kembe	litra	4	24 muaj
11	Furnizim & vendosje sprajt graso	cope	4	24 muaj

12	Sherbim ngjitje, kruarje, lyerje me boje	cope	2	24 muaj
Skaf Plastik vendndodhja Shëngjin, Motorri Selva, Fuqia 50 HP				
Nr.	Emërtimi i Shërbimit	Njësia	Sasia e pritshme	Afati i ekzekutimit
1	Furnizim & vendosje filter benzine	cope	2	24 muaj
2	Furnizim & vendosje parafilter benzine	cope	2	24 muaj
3	Furnizim & vendosje impeler	cope	2	24 muaj
4	Furnizim & vendosje termostat	cope	2	24 muaj
5	Furnizim & vendosje helike	cope	2	24 muaj
6	Furnizim & vendosje tub shkarkimi	cope	2	24 muaj
7	Furnizim & vendosje gomine e kembes	cope	2	24 muaj
8	Furnizim & vendosje flotorq hub	kit	2	24 muaj
9	Furnizim & vendosje vaj motorri Selva 50 HP	litra	12	24 muaj
10	Furnizim & vendosje vaj kembe	litra	4	24 muaj
11	Furnizim & vendosje sprajt graso	cope	4	24 muaj
12	Sherbim ngjitje, kruarje, lyerje me boje	cope	2	24 muaj
Skaf plastik vendndodhja Korçë, Motorri Marinera, Fuqia 60 HP				
Nr.	Emërtimi i Shërbimit	Njësia	Sasia e pritshme	Afati i ekzekutimit
1	Furnizim & vendosje parafilter benzine	cope	2	24 muaj
2	Furnizim & vendosje filter benzine	cope	2	24 muaj
3	Furnizim & vendosje helike	cope	2	24 muaj
4	Furnizim & vendosje modul pompe benzine	cope	2	24 muaj
5	Furnizim & vendosje pompaci benzine	cope	2	24 muaj
6	Furnizim & vendosje vaj motori 60HP	cope	12	24 muaj
7	Furnizim & vendosje vaj kembe	litra	4	24 muaj
8	Furnizim & Vendosje sprajt graso	cope	4	24 muaj

9	Sherbim ngjitje, kruarje, lyerje me boje	cope	2	24 muaj
Varkë plastike vendndodhja Pogradec, Motorri Diesel, Fuqia 240 HP				
Nr.	Emërtimi i Shërbimit	Njësia	Sasia e pritshme	Afati i ekzekutimit
1	Furnizim & vendosje filter vaji	cope	2	24 muaj
2	Furnizim & vendosje filter nafte	cope	2	24 muaj
3	Furnizim & vendosje parafilter nafte	cope	2	24 muaj
4	Furnizim & vendosje pompe uji	cope	2	24 muaj
5	Furnizim & vendosje termostat	cope	2	24 muaj
6	Furnizim & vendosje termostat	cope	2	24 muaj
7	Furnizim & vendosje helike	cope	2	24 muaj
8	Furnizim & vendosje tub shkarkimi	cope	2	24 muaj
9	Furnizim & vendosje vaj motorri 240 hp	litra	12	24 muaj
10	Furnizim & vendosje sprajt graso	cope	4	24 muaj
11	Sherbim mirmbajtje rrjeti elektrik	ore	4	24 muaj
12	Sherbim ngjitje, kruarje, lyerje me boje	cope	2	24 muaj
Gomone vendndodhja Durrës, Motorri Parsun, Fuqia 25 HP				
Nr.	Emërtimi i Shërbimit	Njësia	Sasia e pritshme	Afati i ekzekutimit
1	Furnizim & vendosje filter benzine	cope	4	24 muaj
2	Furnizim & vendosje parafilter benzine	cope	4	24 muaj
3	Furnizim & vendosje filter vaji	cope	4	24 muaj
4	Furnizim & vendosje pompe uji	cope	2	24 muaj
5	Furnizim & vendosje tub shkarkimi	cope	2	24 muaj
6	Furnizim & vendosje helike	cope	2	24 muaj
7	Furnizim & vendosje modul pompe benzine	cope	2	24 muaj
8	Furnizim & vendosje vaj kembe	litra	4	24 muaj

9	Furnizim & vendosje vaj motorri Parsun 25 HP	litra	16	24 muaj
10	Furnizim & vendosje sprajt graso	cope	4	24 muaj
11	Sherbim miermbajtje rrjeti elektrik	ore	4	24 muaj
12	Sherbim ngjitje, kruarje, lyerje me boje	cope	2	24 muaj
Motorr vendndodhja Sarandë, Motorri Suzuki, Fuqia 25 Hp				
Nr.	Emërtimi i Shërbimit	Njësia	Sasia e pritshme	Afati i ekzekutimit
1	Furnizim & vendosje filter benzine	cope	2	24 muaj
2	Furnizim & vendosje parafilter benzine	cope	2	24 muaj
3	Furnizim & vendosje kandle	cope	8	24 muaj
4	Furnizim & vendosje filter vaji	cope	2	24 muaj
5	Furnizim & vendosje vaj motorri Suzuki 25 HP	litra	16	24 muaj
6	Furnizim & vendosje sprajt graso	cope	4	24 muaj
7	Sherbim ngjitje, kruarje, lyerje me boje varke plastike	cope	2	24 muaj
Skaf plastik vendndodhja Durrës, motorri Suzuki, fuqia 115 Hp				
Nr.	Emërtimi i Shërbimit	Njësia	Sasia e pritshme	Afati i ekzekutimit
1	Furnizim & vendosje filter benzine	cope	2	24 muaj
2	Furnizim & vendosje parafilter benzine	cope	2	24 muaj
3	Furnizim & vendosje pompe uji	cope	2	24 muaj
4	Furnizim & vendosje anoda	set	2	24 muaj
5	Furnizim & vendosje impeler	cope	2	24 muaj
6	Furnizim & vendosje pompaci benzine	cope	2	24 muaj
7	Furnizim & vendosje helike	cope	2	24 muaj
8	Furnizim & vendosje gomine e kembes	cope	2	24 muaj
9	Furnizim & vendosje pakete elektronike (centralin)	cope	2	24 muaj
10	Furnizim & vendosje vaj kembe	litra	4	24 muaj

11	Furnizim & vendosje vaj motorri Suzuki 115 HP	litra	24	24 muaj
12	Furnizim & vendosje sprajt graso	cope	4	24 muaj
13	Sherbim mirembajtje rrjeti elektrik	ore	4	24 muaj
14	Sherbim ngjitje, kruarje, lysterje me boje	cope	2	24 muaj
Skaf plastik vendndodhja Sarandë, Motorri Yamaha, Fuqia 200 HP				
Nr.	Emërtimi i Shërbimit	Njësia	Sasia e pritshme	Afati i ekzekutimit
1	Furnizim & vendosje filter benzine	cope	2	24 muaj
2	Furnizim & vendosje parafilter benzine	cope	2	24 muaj
3	Furnizim & vendosje pompe uji	cope	2	24 muaj
4	Furnizim & vendosje anoda	set	2	24 muaj
5	Furnizim & vendosje impeler	cope	2	24 muaj
6	Furnizim & vendosje pompaci benzine	cope	2	24 muaj
7	Furnizim & vendosje helike	cope	2	24 muaj
8	Furnizim & vendosje flotorq hub	set	2	24 muaj
9	Furnizim & vendosje gomine e kembes	cope	2	24 muaj
10	Furnizim & vendosje pakete elektronike (centralin)	cope	2	24 muaj
11	Furnizim & vendosje vaj kembe	litra	4	24 muaj
12	Furnizim & vendosje vaj motorri Yamaha 200 HP	litra	24	24 muaj
13	Furnizim & vendosje sprajt graso	cope	4	24 muaj
14	Sherbim mirembajtje rrjeti elektrik	ore	4	24 muaj
15	Sherbim ngjitje, kruarje, lysterje me boje	cope	2	24 muaj
Gomone vendndodhja Durrës, Motorri: Mercury, Fuqia: 300 HP				
Nr.	Emërtimi i Shërbimit	Njësia	Sasia e pritshme	Afati i ekzekutimit
1	Furnizim & vendosje kandelet	cope	12	24 muaj
2	Furnizim & vendosje filter vaji	cope	2	24 muaj

3	Furnizim & vendosje parafilter benzine	cope	2	24 muaj
4	Furnizim & vendosje filter benzine	cope	2	24 muaj
5	Furnizim & vendosje termostat	cope	2	24 muaj
6	Furnizim & vendosje pompe uji	set	2	24 muaj
7	Furnizim & vendosje vaj kembe	litra	2	24 muaj
8	Furnizim & vendosje maneta	cope	2	24 muaj
9	Furnizim & vendosje tub shkarkimi	cope	2	24 muaj
10	Furnizim & vendosje helike	cope	2	24 muaj
11	Furnizim & vendosje gomine e kembes	cope	2	24 muaj
12	Furnizim & vendosje bobina korenti	cope	12	24 muaj
13	Furnizim & vendosje rele	cope	2	24 muaj
14	Furnizim & vendosje fisha e sigureses se motorit	cope	2	24 muaj
15	Furnizim & vendosje set montimi i helikes	cope	2	24 muaj
16	Furnizim & vendosje volant	cope	2	24 muaj
17	Furnizim & vendosje Izolator ajri	cope	2	24 muaj
18	Furnizim & vendosje sensor benzine	cope	2	24 muaj
19	Furnizim & vendosje set fisha komandimi	cope	2	24 muaj
20	Furnizim & vendosje vaj motorri Mercury 300 HP	litra	24	24 muaj
21	Furnizim & vendosje sprajt graso	cope	4	24 muaj
22	Riparim tubolari	ore	2	24 muaj
23	Sherbim mirembajtje rrjeti elektrik	ore	4	24 muaj
24	Sherbim ngjitje, kruarje, lysterje me boje	cope	2	24 muaj
Gomone vendndodhja Vlorë, Motorri: Mercury, Fuqia: 300 HP				
Nr.	Emërtimi i Shërbimit	Njësia	Sasia e pritshme	Afati i ekzekutimit
1	Furnizim & vendosje kandelet	cope	12	24 muaj

2	Furnizim & vendosje filter vaji	cope	2	24 muaj
3	Furnizim & vendosje parafilter benzine	cope	2	24 muaj
4	Furnizim & vendosje filter benzine	cope	2	24 muaj
5	Furnizim & vendosje termostati	cope	2	24 muaj
6	Furnizim & vendosje pompe uji	set	2	24 muaj
7	Modul pompe benzine	cope	2	24 muaj
8	Furnizim & vendosje komba e helikes	cope	2	24 muaj
9	Furnizim & vendosje vaj kembe	litra	4	24 muaj
10	Furnizim & vendosje maneta	cope	2	24 muaj
11	Furnizim & vendosje tub shkarkimi	cope	2	24 muaj
12	Furnizim & vendosje gomine e kembes	cope	2	24 muaj
13	Furnizim & vendosje bobina korenti	cope	12	24 muaj
14	Furnizim & vendosje rele	cope	2	24 muaj
15	Furnizim & vendosje fisha e sigureses se motorit	cope	2	24 muaj
16	Furnizim & vendosje set montimi i helikes	cope	2	24 muaj
17	Furnizim & vendosje volant	cope	2	24 muaj
18	Furnizim & vendosje farfalle	cope	2	24 muaj
19	Furnizim & Vendosje izolator ajri	cope	2	24 muaj
20	Furnizim & vendosje sensor benzine	cope	2	24 muaj
21	Furnizim & vendosje set fisha komandimi	cope	2	24 muaj
22	Furnizim & vendosje vaj motorri Mercury 300 HP	litra	24	24 muaj
23	Furnizim & vendosje sprajt graso	cope	4	24 muaj
24	Riparim tubolari	ore	2	24 muaj
25	Sherbim mirembajtje rrjeti elektrik	ore	4	24 muaj
26	Sherbim ngjitje, kruarje, lyerje me boje	cope	2	24 muaj
Trajlера Skafesh				

Nr.	Emërtimi i Shërbimit	Njësia	Sasia e pritshme	Afati i ekzekutimit
1	Furnizim & vendosje nofull pistocine	cope	12	24 muaj
2	Ferrota frenash	cope	12	24 muaj
3	Furnizim & vendosje tamburo freni	cope	12	24 muaj
4	Furnizim & vendosje dadicek gome	cope	10	24 muaj
5	Furnizim & vendosje kavo Frenash	cope	12	24 muaj
6	Furnizim & vendosje mbajtese (ganxh rimorkio)	cope	6	24 muaj
7	Furnizim & vendosje kemba e trajlerit me rrote	cope	6	24 muaj
8	Furnizim & Vendosje rrula	cope	50	24 muaj
9	Furnizim & Vendosje krik, kavo trajleri dhe krahe kriku	cope	6	24 muaj
10	Saldim, kruarje, lyerje me boje	cope	12	24 muaj

Shtojca 8.

(Shtojcë për t'u plotësuar nga Autoriteti/Enti Kontraktor)

FORMULARI I TERMAVE TË REFERENCËS

Objekti dhe qëllimi i shërbimeve: **“Mirëmbajtje e mjeteve lundruese për Drejtorinë e Shërbimeve të Peshkimit dhe Akuakulturës Tiranë”.**

Përkufizime

1. Mirëmbajtja teknike e mjeteve lundruese. Nënkupton kryerjen e shërbimeve të riparimit dhe mirëmbajtjes së motorëve, sistemeve mekanike, elektrike dhe të konstruksioneve të jashtme të mjeteve lundruese të destinuara për transportin ujor të udhëtarëve dhe mallrave.

2. Veprimtari riparimi. Janë të gjitha operacionet që lidhen me zëvendësimin, rikonstruksionin, modifikimin ose restaurimin e çdo komponenti të mjeteve lundruese, përfshirë motorët, sistemet mekanike, elektrike dhe konstruksionet e jashtme, si dhe instalimin e impianteve dhe komponentëve fiks në një mjet ose në një kompleks mjetesesh lundruese.

3. Veprimtari mirëmbajtjeje të mjeteve lundruese. Nënkupton shërbimet e mirëmbajtjes parandaluese dhe korrigjuese të pjesëve mekanike, motorike, elektrike, hidraulike, të karrocërisë dhe të strukturës së përgjithshme të mjetit lundrues, me qëllim garantimin e funksionimit të sigurt dhe efikas të tij.

4. Agregat. Është një njësi funksionale e përbërë nga disa pjesë këmbimi të ndryshme, të lidhura në mënyrë të lëvizshme ose të palëvizshme për të kryer një proces të caktuar pune dhe që paraqet një vlerë monetare relativisht të lartë. Në këtë kategori përfshihen, ndër të tjera, motori, kutia e shpejtësisë, helikat dhe sistemet e komandimit.

5. Pajisje. Është një njësi e përbërë nga disa pjesë këmbimi të kombinuara që kryen një funksion të caktuar dhe ka një vlerë monetare relativisht mesatare. Në këtë kategori përfshihen, ndër të tjera, pompat, motorinot, panelet elektrike, pistonët e ngritjes së këmbës së motorit, këmbët e motorit dhe helikat.

6. Pjesë këmbimi. Janë elemente të veçanta ose grupe detalesh që kryejnë një funksion specifik në mjetin lundrues dhe kanë vlerë monetare relativisht të ulët. Në këtë kategori përfshihen, ndër të tjera, anodat, klemat e baterive, filtrat, kavot, ingranazhet, kushinetat, premistopat, gominat dhe elementë të ngjashëm.

Vendi i Kryerjes dhe Dorëzimit të Shërbimeve, Shërbimet objekt kontrate do të kryhen:

-
- pranë vendbazimit të mjeteve lundruese të Autoritetit Kontraktor; ose
 - pranë servisit/objektit të operatorit ekonomik të kontraktuar,
- sipas natyrës së defektit, llojit të ndërhyrjes së nevojshme dhe marrëveshjes së palëve, duke siguruar në çdo rast cilësinë dhe afatet e kërkuara të shërbimit.

Shtojca 9

[Shtojcë për t'u plotësuar nga Autoriteti/Enti Kontraktor]

FORMULAR I I KRITEREVE TË PËRZGJEDHJES/KUALIFIKIMIT

1. KRITERET E PËRGJITHSHME TË PËRZGJEDHJES/ KUALIFIKIMIT

Ofertuesi deklaron se:

- a) është i regjistruar në regjistrin tregtar sipas legjislacionit të vendit ku ushtron aktivitetin, ose sipas legjislacionit të posaçëm në rastin e një organizate jofitimprurëse, ka në fushën e veprimtarisë objektin e prokurimit, dhe ka statusin aktiv;
- b) nuk është në proces falimentimi (status aktiv);
- c) nuk është dënuar për ndonjë vepër penale, në përputhje me nenin 76/1 të LPP-së;
- ç) personi (personat) që veprojnë si anëtar i organit administrativ, drejtori ose mbikëqyrësi, aksioneri ose ortak, ose që ka fuqi përfaqësuese, vendimmarrëse ose kontrolluese brenda Operatorit Ekonomik, nuk është i dënuar ose nuk ka qenë i dënuar nga një vendimi i gjykatës i formës së prerë për çdo vepër penale, të përcaktuar në nenin 76/1 të LPP-së;
- d) nuk është shpallur fajtor për shkelje të rëndë profesionale, për sa kohë që nuk është parashkuar, sipas legjislacionit në fuqi;
- dh) nuk ka pagesa të pashlyera të taksave dhe kontributeve të sigurimeve shoqërore, ose ndodhet në një prej kushteve të parashikuara në nenin 76/2 të LPP-së;
- e) ka paguar energjinë elektrike dhe plotëson kërkesat që burojnë nga legjislacioni në fuqi. Ky informacion kërkohet për Operatorët Ekonomikë, të cilët operojnë në territorin e Republikës së Shqipërisë.
- f) nuk është në kushtet e konfliktit të interesit, sipas legjislacionit në fuqi;
- g) ushtron veprimtarinë në përputhje me legjislacionin përkatës mjedisor, social dhe të punës;
- gj) ka paraqitur një Ofertë të Pavarur, sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi;
- h) kryen aktivitetin në përputhje me kërkesat e legjislacionit në fuqi.
- i) nuk ka në cilësinë e anëtarit të organit të administrimit, drejtues ose mbikëqyrës i atij, aksionar ose ortak, ose me kompetenca përfaqësuese, vendimmarrjeje ose kontrolluese brenda

tij persona të cilët janë/kanë qenë në këtë cilësi në një operator ekonomik të përjashtuar nga e drejta për të fituar kontrata publike, me vendim të Agjencisë së Prokurimit Publik, gjatë kohës që ky vendim është në fuqi.

j) ka regjistruar pronarët përfitues në regjistrin e pronarëve përfitues, sipas parashikimeve të legjislacionit në fuqi;

k) zbaton detyrimet që rrjedhin nga legjislacioni në fuqi për pagat bazë referuese për kategori profesioni për punonjësit e pajtuar në punë. Ky informacion kërkohet për Operatorët Ekonomikë, i regjistruar në regjistrin tregtar shqiptar.

Këto kritere duhet të përmbushen me paraqitjen e Formularit Përmbledhës të Vetëdeklarimit të operatorit ekonomik në ditën e hapjes së Ofertës, sipas Shtojcës 10.

Në rast bashkimi të operatorëve ekonomikë, secili anëtar i grupit duhet të paraqesë Vetëdeklarimin e lartpërmendur.

Në rast se, operatori ekonomik ofertues do të mbështetet në kapacitetet e subjekteve të tjera, Vetëdeklarimi i lartpërmendur duhet të paraqitet edhe nga subjekti mbështetës.

Kriteret e Përgjithshme të Pranimit nuk duhet të ndryshohen nga Autoritetet/Entet Kontraktore.

Në çdo rast, Autoriteti/EntiKontraktor ka të drejtë të kryejë verifikimet e nevojshme për vërtetësinë e informacionit të deklaruar nga Operatori Ekonomik, për sa më sipër.

➤ Nëse oferta paraqitet nga një bashkim Operatorësh Ekonomikë, do të paraqitet :

Marrëveshje bashkëpunimi ndërmjet Operatorëve Ekonomikë, ku caktohet përfaqësuesi, përqindja e pjesëmarrjes në bashkim, dhe elementët që merr përsipër të realizojë secili prej anëtarëve të bashkimit.

➤ Nëse, një operator ekonomik dëshiron të mbështetet në kapacitetet e subjekteve të tjera, ai i vërteton autoritetit ose entit kontraktor se do të ketë në dispozicion burimet e nevojshme, duke dorëzuar një angazhim me shkrim të këtyre subjekteve për këtë qëllim.

2. KRITERET E VEÇANTA TË KUALIFIKIMIT

1. Ofertuesi duhet të paraqesë:

a. *Formularin Përmbledhës të Vetëdeklarimit, sipas Shtojcës 10.*

b. *Sigurimin e Ofertës, sipas Shtojcës 3;*

2. Ofertuesi duhet të paraqesë:

2.1 Kapacitetin profesional të operatorëve ekonomikë:

Sipas kritereve të përgjithshme të kualifikimit, të përcaktuara në pikën 1, Shtojca 9 të DST.

2.2 Kapaciteti ekonomik dhe financiar:

2.2.1 Për të provuar kapacitetet financiare dhe ekonomike, operatorët ekonomikë duhet të paraqesin vërtetim për xhiron vjetore të 3 (tre) viteve të fundit financiare (2023-2024-2025), ku vlera e xhiros për të paktën një nga vitet e periudhës së kërkuar duhet të jetë jo më pak se vlera e fondit limit. *Kriteri konsiderohet i përmbushuar nëse operatorët ekonomikë arrijnë vlerën e xhiros minimale, pra sa vlera e fondit limit, në të paktën 1(një) vit të periudhës së kërkuar të viteve financiare.*

2.2.2 Operatorët ekonomikë duhet të paraqesin bilancet vjetore, për vitet financiare (2023, 2024, 2025), të shoqëruara me Akt Ekspertizen e Ekspertit Kontabël të Autorizuar, vetëm në rastin kur janë në kushtet e përcaktimeve të Ligjit Nr. 10091 datë 05.03.2009 “Për auditimin ligjor, organizimin e profesionit të ekspertit kontabël të regjistruar dhe të kontabilistit të miratuar”, i ndryshuar. Kriteri konsiderohet i përmbushuar nëse në dy bilance të njëpasnjëshme nuk ka raport negative ndërmjet aktivitetit dhe pasivitetit.

2.3 Kapaciteti teknik:

2.3.1. Operatori ekonomik duhet të paraqesë dëshmi për shërbimet e mëparshme të ngjashme, të kryera gjatë tre viteve të fundit nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës, në një vlerë jo më të vogël se 39 % të vlerës së fondit të limit të kontratës.

Për të vërtetuar përvojën e mëparshme të ngjashme, operatorët ekonomikë duhet të paraqesin dëshmitë e mëposhtme:

a) për përvojën e mëparshme të realizuar me sektorin publik, operatori ekonomik duhet të paraqesë vërtetime të lëshuara nga një ent publik për përmbushjen me sukses të kontratës, ku të shënohen vlera, afati i përfundimit të kontratës, ose faturave tatimore të shitjes, të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi, dhe të deklaruara në organet tatimore, ku shënohen datat, shumat dhe shërbimet e realizuara.

b) për përvojën e mëparshme të realizuar me sektorin privat, operatori ekonomik duhet të paraqesë fatura tatimore të shitjes, të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi, dhe të deklaruara në organet tatimore, ku shënohen datat, shumat dhe shërbimet e realizuara.

2.3.2 Operatori ekonomik pjesëmarrës duhet të ketë personelin teknik të nevojshëm për realizimin e kontratës, në përbërje të të cilit të ketë minimalisht 3 (tre) punonjës sipas profileve të mëposhtme:

- a) 1 (një) Teknik i mirëmbajtjes së mjeteve me eksperience minimum 1 vit në fushen detare /navale.
- b) 1 (një) Mekanik motorrësh me eksperience minimum 1 vit në fushen detare /navale.
- c) 1 (një) Elektromekanik me detar me eksperience minimum 1 vit në fushen detare /navale.

Për secilin prej punonjësve në pikat (a, b, c,) më sipër duhet të paraqitet:

- Diploma e arsimit të lartë ose dëshmia e aftësisë profesionale, kontratat e punës (e vlefshme), si dhe Libreze Pune.

Shënim: Ky Kriter konsiderohet i përmbushur me plotësimin e formularit sipas shtojcës 10 të DT. Deklarata provuese të kërkuara më sipër, do të paraqiten nga ofertuesi i kualifikuar i pari, përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit ose nëse kërkohen sqarime nga Autoriteti Kontraktor.

2.3.3 Operatori ekonomik duhet të provojë se disponon ambient, ku ushtron veprimtarinë, për kryerjen e shërbimit të riparimit dhe mirëmbajtjes së mjeteve lundruese.

Për të vërtetuar përmbushjen e këtij kriteri duhet të paraqesin:

